



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Tiranë, më 23.01.2026

Dokument Parlamentar
(Komision përgjegjës)

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR LOBIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. HYRJE

Komisioni për Çështjet ligjore dhe Administratën Publike, në mbledhjen e datës 23 janar 2026, shqyrtoi dhe miratoi projektligjin “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj është propozim i Këshillit të Ministrave, depozituar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më datë 06 janar 2026.

Për prezantimin e projektligjit në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë të Antikorrupsionit, z. Insidor Rexhepi dhe stafi mbështetës nga kjo ministri,

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike e shqyrton këtë projektligj, në cilësinë e **komisionit përgjegjës**, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, me relator znj. Aurora Mara.

Projektligji synon të krijojë një kuadër të plotë, koherent dhe të unifikuar për rregullimin e mënyrës dhe kushteve të ushtrimit të veprimtarisë së lobimit, si dhe për organizimin, identifikimin, regjistrimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e saj, me qëllim garantimin e transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë në proceset e vendimmarrjes publike. Në këtë kuadër, projektligji rregullon veprimtarinë lobuese pranë institucioneve publike të Republikës së Shqipërisë, duke u mbështetur në parimet e transparencës, barazisë së aksesit dhe llogaridhënies, si dhe vendos një regjim administrativ për sanksionimin e shkeljeve.

Në mënyrë më të detajuar, projektligji parashikon rritjen e transparencës së veprimtarisë lobuese përmes krijimit dhe funksionalizimit të Regjistrimit të Lobimit, si dhe vendosjes së detyrimit ligjor për regjistrim dhe raportim periodik nga lobistët dhe zyrtarët publikë. Paralelisht, synohet forcimi i integritetit në vendimmarrjen publike, përmes unifikimit të rregullave të sjelljes për zyrtarët publikë, detyrimit për deklarimin e kontakteve lobuese, parandalimit të konfliktit të interesit dhe aplikimit të periudhave ndaluese për ish-zyrtarët publikë.

Një element tjetër thelbësor lidhet me ngritjen dhe konsolidimin e një mekanizmi efektiv mbikëqyrës dhe ndëshkues, përmes forcimit të kapaciteteve institucionale pranë autoritetit përgjegjës, Komisionit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe përcaktimit të procedurave të qarta për verifikimin, kontrollin dhe sanksionimin e shkeljeve. Po ashtu, projektligji synon të rrisë llogaridhënien dhe transparencën institucionale përmes raportimit të rregullt dhe publikimit të të dhënave mbi aktivitetet lobuese dhe nivelin e zbatimit të tij.

Së fundi, parashikohet rritja e ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve të aktorëve publikë dhe privatë, nëpërmjet fushatave informuese dhe trajnimeve periodike mbi rregullat e lobimit, etikën institucionale dhe transparencën në vendimmarrje.

Në tërësi, këto objektiva kontribuojnë drejtpërdrejt në realizimin e Objektivit 1.8 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, që synon ngritjen e kuadrit ligjor dhe institucional për lobimin si instrument parandalues të korrupsionit, si dhe mbështesin zbatimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës në kuadër të procesit të integritetit evropian.

II. BAZA LIGJORE E PROJEKTLIGJIT, VLERËSIMI KUSHTETUES DHE PROCEDURAL

Komisioni për Çështjet ligjore dhe Administratën Publike e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit.

Projektligji është propozim i Këshillit të Ministrave, në përputhje me parashikimet e nenit 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Nga ana *juridike procedurale*, projektligji i nënshtrohet procedurave të parashikuara në nenin 78 dhe nenin 83, pika 1, të Kushtetutës.

Në aspektin juridik formal-procedural, akti shoqërohet me relacionin përkatës sipas kërkesave të nenit 68, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, si dhe me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA)

dhe raportin individual të konsultimit publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP).

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

III. QËLLIMI DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” është paraqitur në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe synon të vendosë një regjim të qartë dhe të besueshëm për ndërveprimet ndërmjet interesave private dhe zyrtarëve publikë, me qëllim garantimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në proceset e vendimmarrjes publike. Në thelb të tij qëndron nevoja për të bërë të dukshme dhe të gjurmueshme ndikimet që ushtrohen mbi politikëbërjen dhe administrimin publik, duke forcuar kështu besimin e publikut në institucionet demokratike dhe në funksionimin e shtetit të së drejtës.

Qasja e projektligjit është parësisht preventive dhe administrative, e orientuar drejt krijimit të një mjedisi transparent dhe të rregulluar për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit. Ai vendos mekanizma të detyrueshëm të regjistrimit, raportimit dhe mbikëqyrjes, duke mundësuar që lobimi të zhvillohet në mënyrë të hapur, të ndershme dhe të verifikueshme. Në këtë mënyrë, forcohet integriteti i proceseve vendimmarrëse dhe reduktohen rreziqet e ndikimeve të papërshtatshme dhe konflikteve të interesit, duke garantuar njëkohësisht të drejtën e subjekteve për të paraqitur interesa dhe qëndrime pranë institucioneve publike.

Projektligji koncepton lobimin si një veprimtari të strukturuar, të paguar dhe të orientuar drejt ndikimit në vendimmarrjen publike, duke përcaktuar përkufizime thelbësore për lobistin, përfituesin e lobimit dhe marrëdhënien e strukturuar të lobimit. Ai parashikon krijimin dhe administrimin e një regjistri publik të lobimit nga autoriteti përgjegjës, si dhe detyrime konkrete për regjistrim dhe raportim për të gjithë subjektet e përfshira. Këto instrumente synojnë të garantojnë transparencë të plotë dhe gjurmueshmëri të çdo ndërveprimi që synon të ndikojë proceset e politikbërjes.

Projektligji përbën gjithashtu një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të demokracisë dhe modernizimit të administratës publike, pasi formalizon një fushë që deri më tani ka qenë e parregulluar ligjërisht.

Në aspektin ndërkombëtar, projektligji është ndërtuar në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe rekomandimet e GRECO-s, duke adoptuar një model bashkëkohor të qeverisjes së

hapur. Ai reflekton praktikat më të mira evropiane për transparencën dhe integritetin në lobim dhe adreson një nga kërkesat themelore të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë.

IV. KONSULTIMI PUBLIK

Projektligji nuk është konsultuar në Platformën e Konsultimit Publik të Kuvendit, sipas parashikimeve të nenit 68, pika 2/1, por përsa referohet në raportin individual për konsultimin publik, projektligji është konsultuar nga hartuesi në portalin e “Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, për periudhën 24.10.2025 – 21.11.2025.

V. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në aspektin e kushtetutshmërisë dhe respektimit të lirive themelore, projektligji “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” vlerësohet në përputhje me parimet kushtetuese që garantojnë lirinë e shprehjes, lirinë e organizimit dhe të drejtën e pjesëmarrjes në jetën publike. Dispozitat e tij nuk kufizojnë komunikimin qytetar me institucionet publike dhe as veprimtarinë e shoqërisë civile, mediave, akademisë apo advokimin në interes publik, por synojnë të rregullojnë vetëm veprimtarinë lobuese të strukturuar dhe të paguar. Në këtë mënyrë, projektligji ruan ekuilibrin ndërmjet nevojës për rregullim dhe mbrojtjes së hapësirës demokratike të pjesëmarrjes qytetare.

Në aspektin e transparencës dhe të drejtës për informim, projektligji parashikon krijimin e Regjistrimit Publik të Lobimit dhe vendos detyrimin për publikimin e të dhënave mbi subjektet lobuese dhe ndërveprimet e tyre me zyrtarët publikë. Njëkohësisht, vendoset një balancë të arsyeshme ndërmjet transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale, duke u referuar legjislacionit përkatës, çka forcon kontrollin publik pa cenuar të drejtat individuale.

Në aspektin e sigurisë juridike dhe ligjshmërisë, projektligji paraqet përkufizime të qarta dhe të parashikueshme, si dhe përcaktim të saktë të subjekteve që i nënshtrohen ligjit, duke shmangur interpretimet e zgjeruara dhe rrezikun e zbatimit arbitrar. Regjimi i sanksioneve administrative është proporcional, i orientuar drejt korrigjimit dhe respektimit të procesit të rregullt ligjor, duke garantuar të drejtën e ankimit dhe mbrojtjen efektive të subjekteve të prekura.

Në aspektin institucional dhe të mbikëqyrjes, regjistrimi i detyrueshëm i lobistëve dhe mbikëqyrja nga një autoritet i pavarur administrativ përbëjnë mekanizma funksionalë dhe në

koherencë me natyrën e ligjit. Ngarkimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me këtë kompetencë vlerësohet si i harmonizuar me mandatin e tij institucional, ndonëse zbatimi efektiv i ligjit kërkon sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme administrative dhe njerëzore për të shmangur mbingarkesën institucionale.

Në raport me integritetin publik dhe konfliktin e interesit, dispozitat për periudhat ndaluese për ish-zyrtarët publikë, kodin e sjelljes për lobistët dhe parandalimin e përdorimit të pozitës publike për qëllime private janë në harmoni me legjislacionin ekzistues dhe standardet ndërkombëtare për integritetin në qeverisje.

Në aspektin e harmonizimit me dokumentet strategjike kombëtare, projektligji “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” është në përputhje të drejtpërdrejtë me: Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, si dhe Strategjinë Kombëtare Kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030.

Në aspektin e harmonizimit me standardet ndërkombëtare dhe integritetin evropian, projektligji adreson drejtpërdrejt rekomandimet e GRECO-s dhe gjetjet e raporteve të progresit të Bashkimit Evropian. Ai plotëson një boshllëk të evidentuar prej vitesh në kuadrin ligjor shqiptar për transparencën e lobimit dhe vendos rregulla të qarta për monitorimin e ndikimeve private në vendimmarrje, në përputhje me praktikën më të mira evropiane dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe OECD-së.

VI. PËRPUTHSHMËRIA ME ACQUIS E BASHKIMIT EVROPIAN

Ky projektligj nuk synon drejtpërdrejtë përafrimin me acquis-në të Bashkimit Evropian, por është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira evropiane për rregullimin e lobimit. Ai reflekton përputhshmëri me rekomandimin CM/Rec(2017)2 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, si dhe me rekomandimin e OECD-së mbi transparencën dhe integritetin në lobim dhe ndikim.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në vitin 2026 nuk parashikohen efekte financiare shtesë për buxhetin e KDMDHP-së, pasi zbatimi fillestar i ligjit dhe ngritja e Regjistrimit të Lobimit do të realizohen me kapacitetet ekzistuese dhe me mbështetjen teknike të Këshillit të Evropës.

Nga viti 2027 parashikohet zgjerimi i strukturës me rreth 5 punonjës dhe alokimi i fondeve shtesë nga buxheti i shtetit për periudhën 2026–2028 në vlerën 27.2 milionë lekë (22.4 milionë për paga, 1 milion për shpenzime kapitale dhe 3.8 milionë për shpenzime korente).

Mbështetja e donatorëve për 2026–2027 arrin rreth 12.3 milionë lekë, nga të cilat 6 milionë lekë për ngritjen e Regjistrimit në vitin 2026. Në total, fondet e planifikuara për 2026–2028 janë rreth 39.5 milionë lekë, të kombinuara nga burimet buxhetore dhe ato të donatorëve.

VIII. DISKUTIME NË KOMISION

Në mbledhjen e Komisionit, e pranishme për të prezantuar projektligjin, Ministrja znj. Adea Pirdeni, paraqiti dhe argumentoi nevojën për këtë nismë në kontekstin e procesit të integritetit evropian. Ajo theksoi se projektligji “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” përbën një risi në kuadrin ligjor shqiptar, duke rregulluar për herë të parë lobimin si një veprimtari të ligjshme, të kontrollueshme dhe transparente. Kjo nismë adreson një boshllëk normativ të kahershëm dhe e pozicionon Shqipërinë në përputhje me standardet ndërkombëtare të qeverisjes së hapur, transparencës dhe integritetit publik, në funksion të procesit të integritetit evropian.

Ministrja vuri në dukje se risia kryesore e projektligjit qëndron në vendosjen e një kuadri të strukturuar për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit, përmes regjistrimit të detyrueshëm të lobistëve dhe krijimit të një regjistri publik të lobimit, i cili do të sigurojë publikimin sistematik të informacionit mbi subjektet lobuese, interesat që përfaqësojnë, çështjet për të cilat llobojnë dhe kontaktet e zhvilluara me zyrtarët publikë. Njëkohësisht, projektligji vendos mekanizma të rinj detyrues për deklarimin e kontakteve lobuese, duke përfshirë edhe detyrimin e raportimit nga ana e vetë zyrtarëve publikë.

Një tjetër risi e theksuar në prezantim lidhet me përcaktimin e qartë të fushës së zbatimit të ligjit dhe dallimin ndërmjet lobimit të paguar dhe ushtrimit të të drejtave themelore demokratike, si pjesëmarrja në konsultime publike, advokimi qytetar dhe veprimtaritë akademike, të cilat përjashtohen shprehimisht nga koncepti i lobimit kur nuk kryhen kundrejt pagesës dhe jashtë marrëdhënieve të strukturuar lobimi.

Ministrja nënvizoi gjithashtu si risi institucionale ngarkimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me administrimin dhe mbikëqyrjen e regjimit të lobimit, si dhe forcimin e mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesave, përfshirë periudhat e ndalimit për ish-zyrtarët publikë dhe ndalimin e përdorimit të informacionit jo publik për përfitim privat. Në përfundim, u theksua se këto risi pritet të rrisin ndjeshëm transparencën dhe integritetin e vendimmarrjes publike, duke kontribuar në parandalimin e korrupsionit dhe në forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike.

Në fjalën e saj, Relatorja znj. Mara nënvizoi se projektligji është në përputhje me Kushtetutën, procedurat parlamentare dhe Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, si dhe me standardet e Këshillit të Europës dhe rekomandimet e GRECO-s. U theksua se, ndonëse nuk synon përafrim formal me acquis të BE-së, ai reflekton praktikën më të mira evropiane. Në aspektin financiar, relatorja sqaroi se në fazën fillestare nuk parashikohen efekte shtesë buxhetore, ndërsa në periudhën pasuese janë planifikuar fonde dhe mbështetje donatorësh për forcimin e kapaciteteve institucionale.

Relatorja theksoi se projektligji përbën një ndërhyrje sistematike të domosdoshme, e cila synon të formalizojë dhe të bëjë transparent një fushë të rëndësishme të ndërveprimit ndërmjet interesave private dhe vendimmarrjes publike, duke adresuar një boshllëk normativ dhe duke kontribuar në forcimin e integritetit të proceseve demokratike.

Komisioni vlerësoi se rregullimi i lobimit si një veprimtari e ligjshme, e kontrollueshme dhe e verifikueshme përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, si dhe drejt përafrimit me standardet evropiane dhe rekomandimet ndërkombëtare për qeverisjen e hapur dhe parandalimin e korrupsionit.

Në përfundim të diskutimeve, Kryetari z Manja, vlerësoi se projektligji adreson një fushë, e cila ka qënë e parregulluar ligjërisht deri më tani dhe për pasojë ky projektligj e vendos lobimin në termat e ligjshmërisë, transparencës dhe kontrollit institucional.

Në përfundim, Kryetari theksoi rëndësinë e projektligjit dhe standartet që ai garanton. Ai theksoi se ligji synon të kontribuojë drejtpërdrejt në parandalimin e korrupsionit dhe në forcimin e integritetit të zyrtarëve publikë gjatë vendimmarrjeve publike.

Në përfundim të mbledhjes së Komisionit, relatorja dhe anëtarët e komisionit gjatë shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji, sugjeruan dhe miratuan disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

➤ **SHTESA DHE NDRYSHIME SIPAS NENEVE**

1. Në **nenin 5** të projektligjit bëhen këto ndryshime:

➤ Në pikën 3, pas fjalisë së fundit shtohet një fjali e re me këtë përmbajtje:

“Të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për çdo vepër tjetër penale të pacituar më sipër, ndalohen të ushtrojnë veprimtari lobuese sipas afateve të rehabilitimit, të përcaktuara në Kodin Penal”.

➤ Në Paragrafin e dytë të pikës 5, shkronja “c”, për teknikë legjislativë riformulohet:

“Afati i ndalimit për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit fillon nga data në të cilën është shlyer detyrimi për pagesën e taksave ose të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

2. Në **nenin 8 të projektligjit** bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 3, tek fjalia hyrëse fjala “*publikisht*” hiqet.
 - Në pikën 3 shkronja “a”, fjala “*vendbanimin*” zëvendësohet me fjalët “*adresa e ushtrimit të veprimtarisë profesionale*”.
 - Në pikën 3, shkronja “e” fjala “*raportimin*” zëvendësohet me fjalën “*raportimet*” dhe fjala “*vendosura*” zëvendësohet me fjalën “*zhvilluara*”.
3. Në nenin 20 të projektligjit fjalët “kanë interes të drejtëpërdrejtë” zëvendësohen me fjalët “*ushtrojnë funksione publike, funksione vendimmarrëse ose këshilluese në autoritetin publik përkatës*”.

IX. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar në fuqi; dhe

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me parashikimet në Rregulloren e Kuvendit;

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, në cilësinë e komisionit përgjegjës, pasi shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për ta përcjellë projektligjin së bashku me shtesat dhe ndryshimet përkatëse në seancë, sipas Rregullosës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

RELATORE

AURORA MARA

KRYETAR

ULSI MANJA